



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

QENDRA PSIKO-SOCIALE 'VATRA'

Nr. 496 Prot, datë 23.02.2026

Nr. 789 Prot, datë 23.02.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE, me adresë: L.Pavarësia, Rruga "Kosova", 9400 Vlorë, përfaqësuar nga **Prof.Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektorit.**

DHE

QENDRËS PSIKO-SOCIALE 'VATRA', organizatë jofitimprurëse e regjistruar me vendim nr. 211, datë 17.01.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me adresë: Rruga 'Nermin Vlora Falaski', Vlorë Shqipëri, përfaqësuar nga **Znj. Brikena Puka**, Drejtore Ekzekutive, me objekt veprimtarie:

- Parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës dhe abuzimit seksual
- Identifikimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin e viktimave të trafikimit, dhunës dhe abuzimit seksual
- Ofrimin e shërbimeve dhe ekspertizës për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, dhunës dhe abuzimit seksual
- Aksesin në drejtësi për viktimat e trafikimit, dhunës dhe abuzimit seksual
- Ndërtimin e kapaciteteve të përfaqësuesve të institucioneve qeveritare dhe joqeveritare
- Lobimin dhe avokimin (kontribut për hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit e politikave shqiptare)
- Bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse dhe organizatat aktive në fushën e mbrojtjes së viktimave të trafikimit, dhunës dhe abuzimit seksual

DUKE MARRË NË KONSIDERATË

- Qëllimin e përbashkët për edukimin, fuqizimin e të rinjve dhe parandalimin e fenomenit të trafikimit, dhunës me bazë gjinore dhe abuzimit seksual dhe fenomeneve të tjera sociale që lidhen kryesisht me të rinjtë;
- Nevojën për një bashkëpunim ndërinstitutional që do të sjellë një kontribut më të efektshëm në këto fusha

DUKE JU REFERUAR

- Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001, "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, nenit 2 pika 6, i cili përcakton angazhimin e OJF-ve për çdo veprimtari që mbështet dhe zhvillon tek individit dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbron jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut dhe nenit 5 sipas të cilit OJF-të e bazojnë veprimtarinë e tyre në parimin e respektimit, të mbrojtjes dhe të zbatimit të të drejtve dhe lirive themelore të njeriut, të parashikuara në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj;
- Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", nenit 12, sipas të cilit e drejta për akses në të dhënat personale, sipas përcaktimeve të këtij ligji, ushtrohet në përputhje me parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe informacionit, lirisë së shtypit dhe sekretit profesional dhe mund të kufizohet, nëse çënon interesat e sigurisë kombëtare, politikën e jashtme, interesat ekonomike dhe financiare të shtetit, parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale;

Palët bien dakord mbi Memorandumin e Bashkëpunimit si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

Marrëveshja ka si qëllim vendosjen e një bashkëpunimi të ndërsjelltë ndërmjet institucioneve, për edukimin, fuqizimin e të rinjve dhe parandalimin e fenomenit të trafikimit, dhunës me bazë gjinore dhe abuzimit seksual dhe fenomeneve të tjera sociale

Përcaktimet e kësaj marrëveshje nuk kanë për qëllim të tejkalojnë parashikimet ligjore mbi bazë dhe në zbatim të të cilëve lidhet kjo marrëveshje.

Neni 2 Angazhimet e palëve

Palët angazhohen që të bashkëpunojnë në respektim dhe zbatim të kërkesave ligjore që burojnë nga ligjet e sipërcituara dhe në mënyrë të veçantë:

1. Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacion për çështje të veçanta për të cilat palët kanë interes të përbashkët, në respektim të ligjeve të posaçme të sipërcituara;

2. Të organizojnë dhe marrin pjesë në takime të përbashkëta për përmirësimin e punës në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga kjo marrëveshje;
3. Të organizojnë çdo formë tjetër të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve në funksion të përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje;
4. Palët bashkëpunojnë për shkëmbimin e praktikave më të mira në nivel kombëtar e ndërkombëtar në fushën e riaftësisimit dhe rintegrimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë, ndër të tjera, në këto drejtime:

- Informimin dhe edukimin e të rinjve dhe studentëve në kuadër të ditëve kombëtare dhe ndërkombëtare, që lidhen me:
 - të drejtat e njeriut;
 - mbrojtjen dhe fuqizimin e vajzave dhe grave;
 - parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe viktimave të mundshme të trafikimit, përmes aktiviteteve ndërgjegjësuere, edukuese dhe informuese.
- Organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve edukative për studentë dhe të rinj;
- Angazhimin e studentëve në grupe pro-bono, vullnetarizëm dhe projekte komunitare;
- Zbatimin e metodologjive inovative;
- Shkëmbimin e ekspertizës akademike dhe profesionale;

Neni 4

Detyrimet e palëve

Qendra Psiko-Sociale “Vatra” merr përsipër:

- a. T’u ofrojë studentëve dhe të rinjve njohuri dhe informacion sensibilizues dhe informues në funksion të fuqizimit dhe ndërgjegjësisimit të tyre lidhur me tematikat e trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës me bazë gjinore, të drejtave të njeriut dhe tematika të tjera sociale për të rinjtë.
- b. Të garantojë që përfaqësuesit që do të zhvillojnë aktivitetet me të rinjtë të jenë me integritet dhe pa konflikt interesi.
- c. Të vendosë në dispozicion stafin e saj, si dhe mjetet logjistike që do të përdoren për zhvillimin e aktiviteteve të organizatës.
- d. Të hartojë dhe të dorëzojë pranë Universitetit raporte mbi aktivitetet e zhvilluar në zbatim të kësaj marrëveshje.
- e. Të respektojë politikat dhe rregulloret e Universitetit gjatë zbatimit të aktiviteteve.

Universiteti “Ismail Qemali” merr përsipër:

- a. Të lejojë dhe të lehtësojë vizitat e përfaqësuesve të Qendrës Psiko-Social ‘Vatra’ në Universitet, sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.
- b. Të lehtësojë përfshirjen e studentëve dhe stafit akademik në aktivitetet e përbashkëta;
- c. Të vendosë në dispozicion ambiente (kur është e mundur) për zhvillimin e aktiviteteve;
- d. Të mbështesë promovimin e iniciativave të përbashkëta brenda komunitetit universitar;
- e. Të emërojë një pikë kontakti për koordinimin e bashkëpunimit.

Neni 5 Komunikimi

Rregulli i përgjithshëm i shkëmbimit të informacionit është ai shkresor dhe/ose nëpërmjet postës elektronike.

Gjithsesi, për të rritur efikasitetin dhe në funksion të dinamikës së çështjeve, palët do të caktojnë person kontakti që do të jenë përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

- Për Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë caktohet _____, me detyrë _____, me adresë e-mail-i: _____
 - Për Qendrën Psiko-Sociale ‘Vatra’ caktohet Znj. Xhensila Murati, me detyrë Menaxhere e Programit, me adresë e-mail-i: info@qendravatra.org.al; xhensila_murati@yahoo.com
- Palët i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimet eventuale të përfaqësuesve.

Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 6 Ndryshime

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar me shkrim paraprakisht palën tjetër.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët nënshkruese dhe shtrin efektin e saj për një periudhë 1 (një) vjeçare, me mundësi rinovimi pas përfundimit të këtij afati dhe me konsensusin e palëve nënshkruese. Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje në gjuhën shqipe dhe me vlerë autentike.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, me datë 23 . 02 . 2026.

PËR
UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”
VLORË

PËR
QENDRËN PSIKO-SOCIALE “VATRA”

REKTORI
Prof.Dr.Aurela Saliaj

DREJTORE EKZEKUTIVE

Brikena PUKA

